

Dhoma e Noterise Tirane
NOTER Leke VATNIKAJ
Nr. 160 Rep



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me daten 15.01.2020 para meje Leke VATNIKAJ , Notere ne qytetin e Tiranes Kamez , rruga "Arberi" ndertesa nr 2, u paraqite personalisht: Mimoza Doçi atesia Ramadan , e datelindjes 20.07.1968 lindur ne Krume Kukes dhe banues ne tirane, 1054 bathore lagje 7, rr. "haki stermilli" 034 00 000 , madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta e tij me nr. Id G85720243C

e cila deklaroj se ky Akte -Themelimi eshte redaktuar sipas vullnetit te saj brenda kesaj zyre e nenshkroi ne pranine time dhe une noteri pasi u binda per identitetin e saj nepermjet dokumentave perkates lejoj nenshkrimin dhe e legalizoj ate sipas ligjit.



NOTER
Leke VATNIKAJ

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"DOÇI FAM" Shpk

Sot me datë 15.01.2020, unë i nënshkruari Zj. Mimoza Doçi, shtetas shqipëtar, e bija e Ramadan dhe Gjyle, e datelindjes 20.07.1968, lindur në Krumë, Kukës, banues në Bathore-Kamëz, Tiranë, identifikuar nga leternjoftimi "G85720243C" madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, dt.14.04.2008 për tregtarët dhe shoqërite tregëtare dhe ligji nr. 9723 date 03.05.2007 për qendër kombëtare të biznesit, kam vendosur të themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të emëruar **"DOÇI FAM"** shpk më poshtë referuar si shoqëria, duke nënshkruar këtë akt themelimi. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të rregullohet nga statusi i saj i cili është pjesë përbërëse e këtij akt themelimi.

Neni 1

Emri i shoqatës është "DOÇI FAM"Sh.p.k

Neni 2

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në adresën, me seli në Bathore, Lagjja 5, Rruga "Demokracia", Kompleksi "Belba".

Gjate ushtrimit të aktivitetit të saj Shoqëria, mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë qendrës së biznesit QKB.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

Zyrë Këmbimi Valutor

Agjent i Shërbimit Komisioner, transfertat parashë për llogari të një subjekti jo bankë

Agjenci Udhëtimi, Biletari

Aktivitet në kryerje të Operacioneve Tregtare dhe Industriale - Financiare

Rimbushje të Telefonisë Celulare, Pagesa të ndryshme për të tretët

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë lekë).

I zotëruar 100% nga ortaku i vetëm.

Kapitali themeltar është i përbërë nga një pjesë kapitali, të gjitha të nënshkruar dhe të paguar, me vlerën prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë lekë) secila.

Neni 6

Derdhja e kapitalit është bërë pranë bankës.

Neni 7

Pjesët e kapitalit janë të rasferueshme ndaj të tretëve tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara në statutin e shoqërisë.

Neni 8

Shoqëria administrohet nga administratori i shoqërisë MIMOZA Doçi, shtetase shqipëtare, e bija e Ramadan dhe Gjyle, e datelindjes 20.07.1968, lindur në Krumë, Kukës, banues në Bathore-Kamëz, Tiranë, identifikuar nga leternjoftimi "G85720243C" madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërsëritje.

Administratori ka të drejtë të plotë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryej të gjitha llojet e veprimtarive dhe cdo lloj marreveshjeje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë, duke përjashtuar rastet që janë të parashikueshme në ligj dhe në statut që i takojnë Vendimit të Ortakut të vetëm. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaria vjetore, hartohen nga administratori.

Neni 9

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha aktivitetet e shoqërisë i besohen një eksperti ose revizorit kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa të përcaktohet me ligj, dhe mund të rizgjidhet. Asambleja cakton dhe përbliimin përkatës kur nuk ka norma ligjore.

Neni 10

Akti i themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

"DOÇI FAM" SHPK

MIMOZA DOÇI

Mimoza Doçi
